



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 55 prot.

Tiranë, më 11. 01. 2021

**V E N D I M**

**Nr. 02, datë 11. 01. 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 155, datë 22.12.2020, e shtetasit T. D., kundër Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Shkallës së Parë dhe Apelit për Krime të Rënda, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Dibër, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krime të Rënda, Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Gjykatës së Lartë, me pretendim diskriminimin për shkak të *“etnisë dhe bindjeve fetare”*<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaroi se ka filluar punë në sistemin e Prokurorisë që nga muaji mars i vitit 1998 në detyrën e oficerit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat. Këtë detyrë ankuesi e ka mbajtur deri më datë 20.01.2000, ku me dekretin e Presidentit të Republikës është emëruar Prokuror në të njëjtën Prokurori.

Në nëntor të vitit 2000, për shkak të profesionalizmit, ankuesi është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbini, në të cilën ka punuar me përkushtim për rreth 4 vjet. Sipas ankuesit,

<sup>1</sup> Ankuesi pretendon se për shkak se ai është besimtar i katolik.

për shkak të punës pa kompromis me krimin, mes tij dhe drejtuesve kanë filluar përplasjet, me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme dhe më pas me Prokurorët e Përgjithshëm ndër vite. Fillimisht, ish Prokurori i Përgjithshëm A. R., ka propozuar shkarkimin e ankuesit nga detyra, por një gjë e tillë nuk është miratuar nga ish Presidenti i asaj kohe R. M. Në vitin 2003, sipas ankuesit, nga ana e Këshillit të Prokurorisë i është dhënë vërejtje “*paralajmërim për shkarkim nga detyra*”, vetëm sepse nuk ka zbatuar urdhërat e kundraligjshëm të ish Prokurorit të Rrethit të Kurbinit të asaj kohe.

Sipas ankuesit, për shkak të arrestimit të një ish shoqëruesi të një Ministri, e njëjta situatë është përsëritur sërish në vitin 2006, ku ndaj tij është marrë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra*”. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, ankuesi sqaron se është goditur nga ish Prokurori i Përgjithshëm Th. S. dy herë për shkak se nuk i nënshtrohej urdhrave të tij dhe nuk kishte përkrahje.

Në vitin 2009, ish Prokurorja e Përgjithshme I. R., ka marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të ankuesit. Për këtë masë, ankuesi i është drejtuar me ankim Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka rrëzuar pretendimet e tij. Këtë vendim, ankuesi e ka ankimuar sërish në Gjykatën e Lartë, e cila vendimin nr. 495, datë 03.11.2011, ka shpallur të kundraligjshme veprimet e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe ka urdhëruar rikthimin e ankuesit në detyrë. Pavarësisht, vendimit të Gjykatës së Lartë, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, nuk u ndërmorr asnjë hap për zbatimin e tij dhe rikthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm.

Pas largimit të I. R. nga pozicioni i Prokurorit të Përgjithshëm, u emërua A. Ll., i cili zbatoi menjëherë vendimin e Gjykatës dhe e riktheu ankuesin në detyrën e mëparshme. Sipas ankuesit, si një formë dënimi, padrejtësisht e në kundërshtim me ligjin, më datë 26.11.2013 është transferuar në detyrën e Prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Dibër. Sipas tij, shkak i transferimit ishte korruptiv, sepse nuk i jepte lekë Prokurorit të Përgjithshëm. Argumenti ligjor i këtij transferimi ishte riorganizimi i institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Lidhur me transferimin e tij, ankuesi i është drejtuar fillimisht Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila vendosi shpalljen e moskompetencës duke e dërguar për kompetencë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Në fund, sipas ankuesit gjykatat kanë rrëzuar kërkesën e tij, ndërkohë që për 4 prokuror të tjerë janë shprehur pro tyre. Aktualisht çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Nga data 26.11.2013 deri më datë 31.10.2016, ankuesi ka mbajtur detyrën e Prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, kur me urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm është pezulluar nga detyra. Arsyeja e pezullimit, sipas tij, ishte se më datë 21.10.2016, televizioni Top

Channel, ka publikuar një video të falsifikuar, në të cilën ankuesi ishte i përfshirë në një situatë korruptive. Mbi këtë bazë, Prokuroria e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda ka dërguar për gjykim çështjen e ankuesit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Kjo gjykatë me vendimin nr. 88, datë 26.07.2018, pasi ka shqyrtuar e gjykuar procedimin penal në emër të ankuesit, ka vendosur deklarin fajtor të tij për veprën penale të *“korrupsionit pasiv të gjyqtarit e prokurorit”*, parashikuar nga neni 319/c i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim, etj.

Pas ankimit të T. D., duke e konsideruar këtë vendim të padrejte, të pabazuar në prova dhe të kundraligjshëm, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 89, datë 06.11.2018 ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke deklaruar fajtor T. D. për veprën penale të *“moskallzimit të krimit”*, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin me 1 vit burgim, vendim për të cilin ankuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në vijim ankuesi pretendon ndër të tjera se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt nga ana e Prokurorisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve. Gjithashtu, ankuesi pretendon se Prokuroria dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve, nuk kanë mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e gjykimit të çështjes së Kryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë L. B., të Presidentit të Republikës së Shqipërisë I. M., të vëllait të ish Ministrit të Brendshëm F. Xh.

Pra, në përfundim ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij fetare, duke qënë se është një besimtar katolik, nga ana e insitucionit të Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Prokurorisë së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, Gjykatës së Lartë, Televizionit Top Channel e një sër mediave, gazetave e portaleve të Shqipërisë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e situatës diskriminuese, asistencën ligjore në të gjitha proceset administrative e gjyqësore në mënyrë që institucionet, Prokuroritë e Gjykatat të zbatojnë ligjin dhe të heqin dorë nga diskriminimi dhe të zhvillojnë e të aplikojnë një proces të rregullt Kushtetues e ligjor.

### **Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,*

*vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*A. Lidhur me kundërshtimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Prokurorisë së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Gjykatës së Lartë.*

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me problematikën që ka patur me duke filluar me masat disiplinore të ndërmarra ndaj tij e duke vijuar më tej me largimin nga puna që kryente si Prokuror. Gjithashtu, sa i përket veprimeve të kryera në dëm të ankuesit, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme dhe organve në varësi të saj, ai i është drejtuar me ankim organeve gjyqësore si: Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Prokurorisë së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, Gjykatës së Shkallës

së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Gjykatës së Lartë.

Në përfundim, organet gjyqësore të cituara më sipër, pasi kanë shqyrtuar ankimet e subjektit ankues, i kanë rrëzuar ato. Në këto kushte ankuesi ka pretenduar pranë Komisionerit se vendimet e ndërmarra prej tyre janë diskriminuese për shkak të bindjeve fetare të tij.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Përsa më sipër dhe referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e ankuesit, ai ka ezauruar rrugën e ankimit të masave disiplinore të marra ndaj tij, duke u shqyrtuar ato nga ana të gjithë organeve të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Pra, në këto kushte, verifikimi i procedurave të ndjekura nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dibër, janë bërë objekt i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, sa i përket veprimeve apo mosveprimeve të ndërmarra nga subjekti Top Channel, kundrejtë ankuesit, evidentohet nga provat e vëna në dispozicion se këto pretendime janë bërë objekt gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 36, i Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, në paragrafin 3, parashikon se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*

Mbështetur në legjislacionin e sipërcituar dhe në kushtet që procedura e ndjekur nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dibër, është shqyrtuar nga organet gjyqësore, në këtë situatë Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, Komisioneri nuk mund të vlerësojë vendimarrjen e gjykatave të sipërcituara.

*B. Lidhur me kërkesën e ankuesit sa i përket, asistencës ligjore në të gjitha proceset administrative e gjyqësore në mënyrë që institucionet, Prokuroritë e Gjykatat të zbatojnë ligjin dhe të heqin dorë nga diskriminimi dhe të zhvillojnë e të aplikojnë një proces të rregullt Kushtetues e ligjor.*

Bazuar në Ankimin Civil, drejtuar Gjykatës së Lartë, Komisioneri u vu në dijeni<sup>2</sup> se referuar objektit të padive drejtuar kësaj gjykate, evidentohet se është dhe konstatimi i diskriminimit ndaj shtetasit T. D. Në këtë kuadër, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se, pretendimet e ankuesit për diskriminim, janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

Kjo reflektohet në çështjet nr. 31155-00755-86-2019, datë 22.02.2019 dhe 31155-02128-86-2020, datë 11.09.2020, kundër Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Presidentit të Republikës etj., paraqitur para gjykatës kompetente nga vetë subjekti ankues. Theksojmë se në objektin e këtyre çështjeve të cilat janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Lartë, është kërkuar edhe konstatimi i diskriminimit të shtetasit T. D.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadija në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiës. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadiës. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadiës, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadiës.”*

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga Gjykata e Lartë, e cila vendos përfundimisht për çështjet.

Në kontekst të sa më sipër, në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte e rrethana janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor; atëherë konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit.

Përsa më sipër, në kushtet kur kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një

<sup>2</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Lista\\_e\\_Ceshtjeve\\_te\\_Ardhura\\_26\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Lista_e_Ceshtjeve_te_Ardhura_26_1.php)

mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkaqet e pretenduara prej tij.

Në referim të nenit 33, pika 7/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”

Bazuar në nenin 36, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “3. Gjykata e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim. 4. Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

Në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Proçedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenin 90, pika 3 e Kodit të Proçedurës Administrative, të ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 4/b, 5, 7, 7/4 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 155, datë 22.12.2020, të T. D., pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Etnia dhe Bindjet fetare

Fusha: Të mira dhe shërbime



